

Presidenti Nishani dekreton emërimin e znj. Mimi Kodheli, ministër i Mbrojtjes

# Mimi Kodheli, ministrja e re e Mbrojtjes

Më 11 shtator 2013, me propozimin e kryeministrit Edi Rama, Presidenti i Republikës Bujar Nishani dekretoi emërimin e znj. Mimi Kodheli, Ministre e Mbrojtjes. Ajo ka lindur në Tiranë më 11 shtator 1964. Ajo është e martuar me Lekën dhe kanë një djalë, Mikelin. Znj. Kodheli është Doktorante e Shkencave Ekonomike nga Universiteti i Veronës, Itali, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, prej vitit 2007. Ka një Master në

Administrim Biznesi nga Universiteti i Lincoln, Nebraska, SHBA në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës prej vitit 2000 si dhe është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Dega Financë në vitin 1986. Znj. Mimi Kodheli ka hyrë në politikë në vitin 2002, kur edhe u bë Nënkrjetare e Bashkisë së Tiranës. Në vitin 2005, ajo u emërua Prefekte e Qarkut të Tiranës...

FAQE 5



# Veterani

ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)  
GAZETË DYJAVORE. NR. 65 (296) 16-30 SHTATOR 2013. ÇMIMI: 20 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA

Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Tiranë.

Email: veterani.obvl@yahoo.com

## 71 vjet nga Kuvendi i parë pluralist

Nga Valsin TANELLARI

Në fshatin Pezë, rreth 20 kilometra larg Tiranës, 71 vjet më parë më 16 shtator 1942, u mbajt Konferenca e Pezës, e njohur në historinë e popullit shqiptar si kuvendi i parë pluralist. Protagonistë të këtij kuvendi, ishin përfaqësues të krahinave, besimeve të ndryshme fetare, klasave dhe shtresave me bindje politike nga më të ndryshmet. Kur u mor vendimi për thirrjen e Konferencës, vendi ndodhej i pushtuar nga Italia dhe i rrezikuar me asgjësim total të vlerave më të qenësishme kombëtare, kurse shoqëria shqiptare e mbërthyer në probleme dhe kontradikta të mprehta politike, ideologjike dhe sociale. Në Pezë, kuvenduan nacionalistë, demokratë, komunistë dhe zogistë, duke iu dhënë rrugëzgjdhje çështjeve të bashkimit të popullit si çështje kardinale për të ruajtur identitetin kombëtar. Në këtë konferencë morën pjesë personalitete të rrymave të ndryshme politike, që nga Abaz Kupi, Mustafa Gjinishi dhe Myslym Peza, që përfaqësonin shtresat patriotike të asaj kohe. Konferenca e Pezës u karakterizua nga debate të gjalla, disa herë të ashpra për probleme të rëndësishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të strategjisë dhe të taktikës së saj. Mendimet e patriotëve vinin në këtë mbledhje nga pozicionet, mentalitetet dhe interesat e ndryshme të delegatëve, respektivisht të forcave politike që ato përfaqësonin. "Pikëpamjet politiko-shoqërore të rrymave të ndryshme nuk duhet të bëhen pengesa për luftën e popullit shqiptar", u theksua ndër të tjera në këtë konferencë. Vendimet e kësaj konference, që zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm, me kryetar Kamber Qafmolla, sekretar Mustafa Gjinishi dhe 7 anëtarë, patën jehonë dhe ndikuan në organizimin e popullit shqiptar në ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore.

Pa dyshim vendimi më i rëndësishëm që mori Konferenca ishte krijimi i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si një organizatë mbipartiake, ku do të bënin pjesë të gjithë shqiptarët pa dallim feje apo bindje politike. Përsa i përket çështjes së Kosovës, delegatët vendosën që ajo të zgjidhej në bazë të principit të vetëvendosjes si e parashikonte Karta e Atlantikut. Tani, mbas 71 vjetësh, mbetet i njëjti vlerësim për qëllimet dhe rolin historik të Konferencës së Pezës, çka do të thotë që ajo i qëndroi historisë. Ajo ishte dhe mbeti një ngjarje e rëndësishme e historisë, pikërisht për mesazhet që i dha vendit, në qendër të të cilave ishin liria dhe demokracia, bashkimi dhe qëndresa, fitorja dhe prosperiteti.

FAQE 3

Tribuni i nacionalizmit shqiptar, Heroi i Demokracisë prehet në varrezat e Dëshmorëve të Kombitparësore

# Figura e Azem Hajdarit apelon për unitet e bashkim kombëtar



FAQE 2

Kryetari i OBVL-së, Rrahman Parllaku (gjeneral-lejtnant në pension, Hero i Popullit), nënkryetari Myfit Guxholli dhe anëtarët e kryesisë: Sotir Budina, Vangjel Kokeri e Jorgji Terca bënë homazhe dhe vendosën një kurorë me lule pranë arkivolit me eshtrat e Liderit të Lëvizjes Studentore

PROTAGONISTË TË KUVENDIT TË PEZËS ISHIN PËRFAQËSUES TË KRAHINAVE E BESIMEVE TË NDRYSHME FETARE

## 71-vjet më parë - Peza, Kuvendi i bashkimit të shqiptarëve

Nga Edip OHRI\*

15 VJET PA NJERIUN QË ZË VENDIN E MERITUAR NË PANTEONIN E NDERIT TË KOMBIT SHQIPTAR

## Dr. Ymer Dishnica, i sakrifikuari i madh

Një nga figurat më simpatike, më të mençura, më fisnike dhe një nga udhëheqësit kryesorë të PKSh dhe LANÇ-it

FAQE 4

## Vetëdija historike dhe identiteti europian i Kosovës

Nga Enver Hoxhaj ministri i Jashtëm i Kosovës

FAQE 8

# Tribuni i nacionalizmit shqiptar, Heroi i Demokracisë prehet në varrezat e Dëshmorëve të Kombit

## Figura e Azem Hajdarit apelon për unitet e bashkim kombëtar

• Kryetari i OBVL-së, Rrahman Parllaku (gjeneral-lejtnant në pension, Hero i Popullit), nënkryetari Myfit Guxholli dhe anëtarët e kryesisë: Sotir Budina, Vangjel Kokeri e Jorgji Terca bënë homazhe dhe vendosën një kurorë me lule pranë arkivolit me eshtrat e Liderit të Lëvizjes Studentore

Azem Hajdari, Heroi i Demokracisë, u shoqërua më 12 shtator në varrezat e Dëshmorëve të Kombit, përmes një ceremonie të organizuar nga Bashkia e Tiranës, në 15 vjetorin e vrasjes së tij. Për më shumë se dy orë në Pallatin e Kongreseve, qindra simpatizantë, të afërm, miq e politikanë, si dhe veteran të OBVL-së bënë nderimet e fundit për Azem Hajdarin. Në homazhe morën pjesë personalitete të larta të jetës politike, Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, Kryetari i parlamentit, Ilir Meta, ministra të qeverisë Rama, kryetarë të partive politike në vend, Ambasadorë të akredituar në vendin tonë, si dhe studentë të dhjetorit '90, intelektualë, nismëtarë të lëvizjes për demokraci, miq, shokë dhe kolegë të Azem Hajdarit.

Në emër të kryesisë së OBVL-së, Kryetari Rrahman Parllaku (gjeneral-lejtnant në pension, Hero i Popullit), nënkryetari Myfit Guxholli dhe anëtarët e kryesisë: Sotir Budina, Vangjel Kokeri e Jorgji Terca bënë homazhe dhe vendosën një kurorë me lule pranë arkivolit me eshtrat e Liderit të Lëvizjes Studentore.

Në një prononcim për mediat Kryetari i Parlamentit dhe kreu i LSI, Ilir Meta, tha se "kujtimi i Azem Hajdarit do të jetë i paharrueshëm dhe

njëkohësisht një ditë e angazhimit për të ardhmen për të plotësuar ëndrrën e tij që Shqipëria të jetë si e gjithë Europa. Ne do të na duhet të tregojmë më shumë urtësi dhe përgjegjshmëri që ëndrra e tij dhe e gjeneratës së tij të bëhet realitet sa më shpejt".

Më tej rreth orës 12:30 kortezhi i përmortshëm me arkivolin e vendosur në shtratit e topit, u nis për në Varrezat e Dëshmorëve, ku u zhvillua dhe ceremonia e rivarrimit.

Kryetari i Partisë Demokratike e njëkohësisht dhe i Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha, në fjalën e tij gjatë ceremonisë së rivarrimit, u shpreh se "ai ishte prijësi i lëvizjes studentore prandaj edhe u vra. Se kishte qënë protagonist për hapjen demokratike të vendit, se kishte qënë themeluesi i PD-së, se kishte qënë mbrojtës i demokracisë dhe çështjes kombëtare. Nuk është e vërtetë se përmbyjsja e komunizmit u bë në mënyrë paqësore, lëvizja për demokraci ka dhënë liderin e saj të parë. Sot figura e tij apelon për unitet dhe bashkim për vlerat kombëtare".

"Ndonëse ka kaluar vetëm një dekadë e gjysmë nga dita e tij e rënies, Azem Hajdari pason rilindasit më të shquar përse i përket vlerësimeve dhe nderimeve institucionale, sepse

Lëvizja e Dhjetorit '90, e drejtuar prej tij, shënoi ndarjen nga diktatura komuniste dhe fillimin e demokracisë perëndimore dhe kjo ishte e do mbetet sot e gjithë ditë rilindja e vërtetë e Shqipërisë pas dekadash izolimi", deklaroi Basha gjatë ceremonisë në Varrezat e Dëshmorëve.

Basha theksoi se Azem Hajdari do të ketë përgjithmonë vendin e merituar në historinë e demokracisë shqiptare. "Besoj se nuk ka asnjë njeri të vetëm e të lirë në këtë vend që nuk i detyrohet atij për hapin që hodhi në Dhjetor '90. Kujtesa e kombit e ka regjistruar Azemin si njeriun që vrau frikën", tha kryetari i PD-së.

"Azemi u vra më 12 shtator '98. Ai u vra se ishte prijësi i lëvizjes studentore, u vra se kishte qënë protagonist për hapjen demokratike të vendit, se kishte qënë themeluesi i orëve të para dhe kryetari i PD-së nga dhjetor '90 deri në shkurt '91 dhe se kishte qënë mbrojtës i demokracisë dhe çështjes kombëtare. Nuk është e vërtetë se përmbyjsja e komunizmit në Shqipëri u bë në mënyrë krejt paqësore. Lëvizja për demokraci ka dhënë liderin e saj të parë, ajo ka paguar me gjakun e Azem Hajdarit, të cilin nuk e vranë në betejën ballore të fillimit, por në kulisat e pa-



besitë e revanshit. Sot figura e tij apelon për unitet dhe bashkim për vlerat kombëtare", u shpreh Basha, ndërsa shtoi se trashëgimia e testamenti i tij politik i përkasin gjithë shqiptarëve, pa dallim krahine apo feje.

Azem Hajdari u lind më 11 mars 1963 në qytetin e Bajram Currit. Ai filloi studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike në 1987, ku u diplomua në vitin 1993 për filozofi. Në vitin 1995 diplomohet si jurist, në Universitetin e Tiranës. Angazhimi i tij politik nis në dhjetor 1990 si udhëheqës i Lëvizjes Studentore, më tej si Kryetar i Komisionit Nismëtar të krijimit të Partisë Demokratike. Në vitet 1991 - 1993 ai u caktua Nënkyretar i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe anëtar i Komitetit të saj

Drejtues. Në 31 mars 1991 Azem Hajdari u zgjodh deputet i Partisë Demokratike të Shqipërisë për Shkodrën. Në 22 mars 1992 u zgjodh deputet i Partisë Demokratike të Shqipërisë për Shijakun. Në 26 maj 1996, u bë pjesë e Kuvendit si deputet i Partisë Demokratike të Shqipërisë për Bulqizën, dhe në 29 qershor 1997 si deputet i Partisë Demokratike të Shqipërisë për Tropojën.

Azem Hajdari, Heroi i Demokracisë, mban titullin më të lartë të Republikës së Shqipërisë "Urdhërin e Flamurit" dhe urdhërin më të lartë në Republikën e Kosovës "Medaljen e Lartë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit", të dhënë nga ish-Presidenti Ibrahim Rugova. Azem Hajdari është Qytetar Nderi i Tiranës dhe pothuajse i të gjithë bashkive dhe komunave të Shqipërisë.

# Pesha e dhimbjes për Azemin

Nga Halil RAMA

Ndonëse autoritetet shtetërore dhe gjithë demokratët e vërtetë i bënë nderimin e merituar duke varrosur eshtrat tek "Dëshmoret e Kombit", e motra e Azemit, Nurija është e pushtuar nga një dhimbje e thellë. 15 vjet pa dhe me Azemin! Pa njeriun më të dashur të zemrës që 12 shtatorin e kobshëm të vitit të mbrapshtë 1998 u ekzekutua nga dora vrasare e bishës gjakatare që kërkonte rikthimin e skëterrës komuniste. Ndërkohë, pranë tij për 15 vite me radhë. Çdo javë, çdo përvjetor ditëlindje e ditëvdekjeje, Nurija, djemtë e vajzat, nipërit e mbesat, me kurora e tufa me lule, me lotë të pashtershëm pranë varrit të Azemit. Madje ajo ngrehinë varrmihëse në Sharrë mund të konsiderohet si "shtëpiza" e dytë e Nurije Hajdarit.

Nuk ka dashuri më të madhe se sa ajo e motrës për të vëllanë. Por tek Nurija kjo është shumëfish më e madhe, sa dhe pesha e dhimbjes. Sepse e ka rritur si vëllanë më të vogël...është kujdesur për të kur ka shkuar në klasën e parë duke i mbështjellë librat...e ka përcellë e pritur kur shkonte e vinte nga shkolla në Tiranë.....E ka mbështetur dhe inkurajuar si askush tjetër në atë dhjetor të furishëm të '90-tës kur doli si uragan kundër sistemit më të egër. Kur u përball me të dhe e rrëzoi. Për të gjitha këto, e motra Nurija sot ndjehet më krenare se kurrë për Azemin.

Nurija ishte vetëm 7 vjeçe atë 11 mars të vitit 1963 kur do të lindte Azemi. Me nostalgji ajo sjell në



praka për në Sharrë...dhe i duket pak si sëprapthi ndryshimi i kahjes së këtyre udhëtimitëve për në Sauk tek varrezat e "Dëshmorëve të Kombit", pranë Monumentit "Nënë Shqipëri" ku do të prehet i qetë tribuni i nacionalizmit shqiptar. Këtë dhimbje e shpreh fytyra e saj e vrosur, e shprehin lotët pambarim që s'po i shtrëjnë gjithë këto ditë. Por edhe kështu e përbotur ajo di ta bëjë vlerësimin për ata që po përbushin më së miri amanetin e Azemit. "I jemi borxhli për jetë Lulzim Bashes, që edhe në këtë rast është projeksioni ynë. Kryebashkiaku që para një viti ishte ndër kryesorët në nismën për vendosjen e monumentit në Qendër të Qytetit "Studenti" nga ku Azemi nisi betejën për shembjen e komunizmit, këtë përvjetor të 15-të të

Po përse ndjehet sot më e trishtuar se kurrë. Jo se nuk krenohet me nderimet që po i bëhen nga bashkëlufëtëtarët, dhjetoristët e '90-tës, nga gjithë shqiptarët demokratë të vërtetë, por sepse ishte mësuar ta merrte çdo tre ditë rrugën nga La-

ekzekutimit të tij, me përgjegjësinë e kryetarit të PD po realizoj varrimin e eshtrave të Liderit të Dhjetorit tek Varrezat e Dëshmorëve të Kombit", -shprehur Nurija. Është ky treguesi më sinjifikativ i vlerësimit për vëllanë tim, vëllanë e gjithë dhjetoristëve të '90-tës, frymëzuesi e brezave të rinjë demokratë që aspirojnë demokracinë e vërtetë.

Azemi tashmë do të jetë më pranë fëmijëve e bashkëshortes së tij shembullore, Fatmirës që për 15 vjet mban hapur derën për të gjithë ata që vijnë e nderojnë Azemin, më pranë shtatores së tij në Qytetin "Studenti" dhe fare pranë Monumentit "Nënë Shqipëri" që ai aq shumë e dëshoi...Po ti vështrosh me vëmendje këto tre skaljone janë

pothuajse në një vijë drejtvizore. Edhe për këtë gjetje Nurija është krenare.

Nderim të veçantë shpreh motra e Dëshmorit të Atdheut, Heroit të Demokracisë, Liderit të Dhjetorit, për Sali Berishën, liderin historik të demokratëve që bëri realitet ëndërrën dhe aspiratat e Azemit. Nëse para një viti në kuadrin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, Berisha e ngriti Azemin në panteonin e figurave më të shquara të kombit, atje ku ai e meriton më shumë se kushdo, sërish sot ideatori i ndryshimeve të mëdha në Shqipërinë e sotme europiane, realizuesi i integriteteve euroatlantike të Shqipërisë dhe frymëzuesi i gjithë shqiptarëve, këtu në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Preshevë e diasporë është bashkë me ta në nderimin që i bëhet Azem Hajdarit. Mirënjohës për jetë Sali Berishës, -shprehur Nurija. Ajo vlerëson maksimalisht ata që nderojnë Azemin. Ai tashmë është i veshur me pavdësi...

Para 15 vitesh, vrasësit u shfaqën në formën e djallit dhe e goditën pa mëshirë. Ata ia kishin menduar vdekjen prej kohësh. Vdekja i erdhi e vrashdhe. I ishte afëruar kushedi sa herë, por pa e frikësuar. Atë natë të 12 shtatorit 1998, erdhi me mot të keq. Duhej të binte shiu dhe të fikeshin dritat. Edhe në errësi, Azemi mendonte për dritën. Ai ishte në betejë me lirinë e kufizuar. Dhe vdekja thonë se është e ëmbël dhe e nderhme kur vdes për liri, ndaj Azem Hajdari ishte një dhanë e madhe për mbarë shqiptarët dhe në mënyrë të veçantë për demokratët anembanë vendit, të cilët me 12 shtator të 1998-tës, e qanë si një hero dhe sot e kujtojnë si një martir të demokracisë.

Çastet e jetës së shkurtër i bëri të përjetshme. Familja e tij sot ngre kokën lart dhe kujton një të vërtetë: Azemi vazhdon të zotërojë... Thjesht, vetëm iku. Fëmijën e vogël e la në barkun e bashkëshortes.

Azemi i vogël s'e njohu dot të atin. Rudinën e pengoi e ëma ta shihte të vdekur. Ajo duhej ta mbante mend vetëm të gjallë. Kiri e pa të rrëzuar me shpresën se do të ngrihej, ashtu shtatë ditë më pas kishte ndodhur edhe në atentatet e tjera. Kurse Fatmira, s'e la dhembjen që t'i mundë, por kujtoi buzëqeshjen e Azemit që tremejt çdo lot dhe frikë, kur i përcolli nga selia e PD-së drejt shtëpisë.

Azem Hajdari u shqua për vetitë e tij, që në fillimin e Lëvizjes Studentore të vitit 1990 për të vazhduar më pas me veprimtarinë e tij politike, duke mbetur në kujtesën historike si një udhëheqës me vlera të rralla demokratike e patriotike, për të cilat atij i është dhënë, pas vdekjes, edhe Urdhri i lartë "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nga Presidenti i Republikës.

Azem Hajdari do të mbahet mend si kalorës i lirisë dhe do të mbetet modeli i politikantit të ri për të guxuar e për të mbrojtur vlerat që ai beson.

Figura e Azem Hajdarit mbetet në memorien e gjithsecilit si një njeri i veçantë e i papërsëritshëm, vetitë e të cilit i përkasin një heroi kombëtar. Natyrisht që vitet kalojnë shumë shpejt, por Azemi mbetet në memorien e gjithsecilit, sidomos të miqve dhe të shokëve të tij. Një njeri shumë i veçantë, me një karakter të fortë, gati-gati të papërsëritshëm. Kjo është arsyeja që ne e kujtojmë Azemin jo vetëm në përvjetorin e rënies së tij, por në çdo moment tjetër kur flitet për heronj.

Nëse para një viti Lideri historik i Dhjetorit u rikthye aty ku 23 vite më parë u prirë studentëve në një lëvizje që do të merrte përmasa mbarëkombëtare për shembjen e një prej diktaturave më të egra që kishte njohur historia e njerëzimit, Azem Hajdari tashmë prehet pranë monumentit "Nënë Shqipëri" me ëndërrën e tij të realizuar: Shqipërinë anëtare të NATO-s dhe me bashkimin e shqiptarëve në BE.

## HISTORIA

# Protagonistë të Kuvendit të Pezës ishin përfaqësues të krahinave e besimeve të ndryshme fetare 71-vjet më parë - Peza, Kuvendi i bashkimit të shqiptarëve

*Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare e Pezës është vazhdim i Kuvendeve historike të popullit shqiptar për bashkim, sepse bashkimi është i vetmi kusht për të korrur fitore. Në Konferencë fitoi ideja që Shqipëria të ishte "Shqipëri e lirë, e pandashme, independente dhe demokratike" (Rez. fq.10). Si përfundim, Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare e Pezës gjeti si zgjidhje më të përshtatshme për t'iu përmbajtur parimit të vetëvendosjes në fund të Luftës, ashtu siç e përmbante Karta e Atlantikut, për të cilën ishin zotuar aleatët e mëdhenj të koalicionit antifashist: SHBA, Rusia dhe Britania e Madhe.*



Nga Edip OHRI\*

Shtatëdhjetëenjë vjet më parë më 16 shtator 1942, u mbajt Konferenca e Pezës, e njohur në historinë e popullit shqiptar si kuvendi i parë pluralist. Protagonistë të këtij kuvendi, ishin përfaqësues të krahinave, besimeve të ndryshme fetare, klasave dhe shtresave me bindje politike nga më të ndryshmet. Kjo konferencë ka hyrë tashmë në Historinë e Shqipërisë si një nga ngjarjet më të rëndësishme të LANÇ të popullit shqiptar.

Konferenca e Parë Pluraliste Nacionalçlirimtare u thirr në kushtet kur Shqipëria kishte tre vjet e gjysëm e okupuar, e cila vuante nga regjimi i egër i pushtimit fashist dhe nga bashkëpunëtorët e brendshëm. Populli shqiptar në këtë kohë, kudo po shtonte urrejtjen, qëndresën dhe aksionet luftarake. Kudo në Shqipëri mbizotëronte një atmosferë lufte për çlirim.

Ideja për thirrjen e Konferencës së parë Nacionalçlirimtare nuk lindi vetëm nga shpirti lirishtetëror dhe luftarak i popullit shqiptar dhe si rrjedhojë e eksperiencës së trashëguar të kuvendeve, por këtë e diktonte edhe faktori ndërkombëtar. Në këtë kohë Lufta e Dytë Botërore po shënonte kulme, po ndërmerrej ofensiva në të gjitha frontet e luftimeve kundër fashizmit, dhe në veçanti krijimi i koalicionit antifashist botëror (SHBA-BS-Britania e Madhe), si dhe Trakti i 27 shteteve, nënshkruar në Uashington, Traktet e Londrës e të Moskës, i dhanë hov e nxitën shpirtin luftarak të rezistencës antifashiste në mbarë Europën e robëruar nga nazifashizmi.

Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare nuk u vendos rastësisht të mbahej në Pezë, por sepse pikërisht këtu në kryeqendren e Shqipërisë zjente lufta për çlirim. Atje do të përballëshin të gjitha mendimet

e opinionet mbarëshqiptare. Tirana, ishte nyja ku mund të grisej maska e manovrave dhe e demagogjive të okupatorit dhe bashkëpunëtorëve të tij vendas.

### Bashkimi kombëtar, imperativ i kohës

Konferenca u përgatit për muaj të tërë, si nga militantët komunistë, ashtu dhe nga shumë patriotë e nacionalistë të qyteteve e krahinave të ndryshme të Shqipërisë. Sigurisht, delegatët nuk u ftuan me një fjalë goje, por me diskutime e debate të forta. Kishte ardhur koha që edhe populli shqiptar të hidhej në luftë më me furi dhe kjo kërkonte organizim në shkallë kombëtare.

Me luftë e sakrificë populli shqiptar do të krijonte kushte optimale për të fituar lirinë dhe independencën kombëtare dhe do të bënte që Fuqitë e Mëdha të koalicionit antifashist ta shikonin me sy të mirë Shqipërinë dhe ta respektonin fqinjët e tij ballkanik. Ky, qe pra, imperativi i kohës: "Nuk ka gjë që mbin e jep më shumë frut se sa gjaku i derdhur".

Konferenca i zhvilloi punimet më 16 shtator 1942 në shtëpinë e Myslim Pezës. Delegatët të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë ishin përfaqësues të të gjitha tendencave: të Nacionalizmit Shqiptar, të PKS, të Rinisë Nacionaliste, të Rinisë Komuniste dhe të Rinisë Femërore Popullore Shqiptare.

Në Konferencë morën pjesë 22 delegatë. Për drejtimin e punimeve u zgjodh kryetar, Ndoc Çoba-ish delegat i Kongresit të Lushnjës dhe anëtar i qeverisë që doli nga ky kongres, atdhetar i dëgjuar.



Platforma e Konferencës përmbante:

1. Domosdoshmërinë e organizimit të luftës kundër okupatorit;
2. Realizimin e bashkimit të popullit shqiptar në interes të LANÇ;
3. Krijimin e Frontit të përbashkët si një levë që do të realizonte bashkimin e popullit në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe do t'i jepte shtrirje kombëtare, duke e bërë platformën e saj pluraliste, ashtu siç për-



caktohet në Rezolucionin e Konferencës së Pezës;

Në Konferencën e parë pluraliste Nacionalçlirimtare të Pezës, delegatët shprehën dëshirën dhe vullnetin e plotë për një organizim të shëndoshë të të gjithë shqiptarëve të vërtetë, pa dallim feje, krahine, klase dhe rryme politike.

4. Krijimin e Këshillit Nacionalçlirimtar si organ lufte në zonat e paçliruara, i cili do të realizonte një sërë detyrash edhe në tokat e çliruara, si organe të pushtetit qeveritar.

Në Rezolucion konsiderohej rëndësia e Këshillave Nacionalçlirimtare, me anën e të cilave do të bëhej qeverisja lokale, mobilizimi i popullit për luftë e për kryengritje.

Të gjithë delegatët pa përjashtim u shprehën për realizimin e këtyre detyrave dhe nga kjo pikëpamje Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare e Pezës iu përgjigj detyrave më të ngutshme të vendit; momentit historik, shtesave të gjera kombëtare, pavarësisht pjessëmarrjes së komunistëve në të si organizatorë që hartuan dhe platformën politike të saj.

Në këtë plan, Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare e Pezës ishte e një rëndësie historike dhe e vetmja rrugë e drejtë, reale për të rifituar pavarësinë.

### Debate të ashpra për formën e regjimit

Çështje të tjera që u ngritën në

këtë konferencë, për të cilat pati debate të forta ishin çështja e regjimit të brendshëm që do të kishte Shqipëria e çliruar dhe problemi i bashkimit kombëtar me Kosovën e me viset e tjera shqiptare të mbetura jashtë kufijve në Shqipërinë e pasluftës. Kështu çështjen e regjimit të brendshëm i takonte ta zgjidhte populli në kushtet e pavarësisë së vendit nëpërmjet shprehjes së lirë të vullnetit të vet.

Në Konferencë fitoi ideja që Shqipëria të ishte "Shqipëri e lirë, e pandashme, independente dhe demokratike" (Rez. fq.10). Si përfundim, Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare e Pezës gjeti si zgjidhje më të përshtatshme për t'iu përmbajtur parimit të vetëvendosjes në fund të Luftës, ashtu siç e përmbante Karta e Atlantikut, për të cilën ishin zotuar aleatët e mëdhenj të koalicionit antifashist: SHBA, Rusia dhe Britania e Madhe.

Në fund Konferenca miratoi unanimisht Rezolucionin që përmbante në mënyrë të koncentruar gjithë platformën dhe që përcaktonte objektivat dhe angazhimet drejt Kryengritjes së Përgjithshme të armatosur.

Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare e Pezës aprovoi edhe Thirrjen që Këshilli i Përgjithshëm NÇ i drejtoi gjithë popullit shqiptar, gjithë luftëtarëve, gjithë antifashistëve, gjithë nacionalistëve pa dallim krahine, besimi, klase dhe ideje që të grumbullonin të gjithë potencialin shpirtëror dhe material në shërbim të Luftës për çlirimin e

Shqipërisë, për një Shqipëri të lirë demokratike të pandarë dhe independente.

### Vazhdim i Kuvendeve historike të popullit shqiptar

Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare e Pezës është vazhdim i Kuvendeve historike të popullit shqiptar për bashkim, sepse bashkimi është i vetmi kusht për të korrur fitore.

Sot populli shqiptar po ecën i sigurtë drejt integritetit në Bashkimin Europian dhe në Aleancën e Atlantikut të Veriut, drejt Europës së qytetëruar dhe demokratike, ashtu siç bëri në vitet e vështira e të lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare duke u radhitur përkrah koalicionit të madh antifashist botëror.

Megjithëse kanë kaluar 70 vjet që kur u mbajt Konferenca e parë pluraliste Nacionalçlirimtare e Pezës, ajo edhe sot e ruan aktualitetin e saj. Ne shqiptarët si komb e si popull duhet të konsolidohemi dhe të bëjmë realitet ëndërrën tonë të pashuar europiane.

Ratifikimi së fundi nga Parlamenti Europian i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian është garanci për një ecuri të mbarë të proceseve integruese, por njëherësh dhe detyrim madhor i secilit për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje historike.

\*Sekretar i Përgjithshëm i OBVL

15 vjet pa njeriun qezë vendin e merituar në panteonin e nderit të kombit shqiptar

# Dr. Ymer Dishnica, i sakrifikuari i madh

*Një nga figurat më simpatike, më të mençura, më fisnike dhe një nga udhëheqësit kryesorë të PKSh dhe LANÇ-it*

Pesëmbëdhjet vjet më parë, (më 22 shtator 1998) u nda nga jeta një nga figurat më simpatike, më të mençura, më fisnike dhe një nga udhëheqësit kryesorë të PKSh dhe LANÇ-it, ish kryetari i parë i OBVL, Dr. Ymer Dishnica. Ai ka qenë një nga figurat më simpatike, më të mençura, më fisnike dhe një nga udhëheqësit kryesorë të LANÇ-it. Ai u lind në fshatin Dishnicë më 21.2.1912, vetëm 4 km afër qytetit të Korçës. Ymer Dishnica është moshatar me pavarësisë kombëtare dhe është bir i denjë i një familje me tradita të shquara atdhetare e cila i ka dhënë Shqipërisë pesë dëshmorë, përfshi edhe një vëllë të doktor Y. Dishnicës. Ai është një nga veprimtarët më të shquar antifashistë frankofonë të Shqipërisë.

Njerëzit si Y. Dishnica kishin cilësi të ralla kulturore, komunikative e propagandistike bindëse. Ai ishte i aftë të bisedonte bindshëm me njerëz të natyrave dhe karaktereve të ndryshme. I edukuar në një ambient fshatar por edhe qytetar si Korça apo Evropian si Parisi dhe Franca kishte aftësi bindëse të çuditëshme. Agjitor i jashtëzakonshëm i tipit të ri antifashist, Ymeri e kuptonte me lehtësi halexhiun nga fshati, qyteti apo aleatët e huaj. Ai nuk ishte njeri i nënshtruar dhe nuk ndjente komplekse inferioriteti ndaj askujt, sidomos ndaj përfaqësuesve të aleatëve. Me përfaqësuesit e forcave kundërshtarë të djathta, doktor Ymeri bisedonte pa kërcënime dhe fyerje dhe ishte në gjendje të kuptonte kompromisin nga nënshtrimi.

Ministri i Shëndetësisë i qeverisë të parë demokratike shqiptare ishte gjithashtu anëtar i KQ dhe Byrosë Politike të PKSh, anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacional Çlirimtar, besnik i kauzës antifashiste dhe komuniste dhe bindjeve të tij të cilat i kishte pëqafuar që shumë kohë para formimit të PKSh kur ndodhej në Francë. Ky personalitet i shquar i kapaciteteve të mëdha, i kalonte përmasat e Shqipërisë, me integritetin e tij intelektual e moral.

Më pas, Ymer Dishnicën e përjashtuan nga KQ i PKSh dhe Byroja Politike dhe kështu filloi kalvari i tij i gjatë i të përndjekurit politik.

## Kush ishte Ymet Dishnica?

Arsimin fillor e nisi në vendlindje dhe përfundoi në Korçë, ndërsa arsimin e mesëm me rezultate të shkëlqyera e përfundoi në Liceun kombëtar francez të këtij qyteti (1932). Pas kësaj Ymer Dishnica u nis për në Francë ku do të studioje për tetë vjet në Universitetin e Lionit dhe më pas atë të Parisit për mjekësi (1932-1941), duke u lauruar e specializuar për patologji.

Y. Dishnica nga natyra ishte njeri intelektual me kërkese dhe kapacitete të larta kulturore. Ai në ato vite kurrësi nuk mund të mos vizitonte Tyleritë dhe muzeumin e famshëm të Luvrit sidhe muzetë e shumtë të Parisit dhe qyteteve të Francës, arkitekturën klasike dhe moderne të Francës. Ai vizitoi teatrot dhe galeritë e shumta të arteve të "kryeqytetit

të botës". Paralel me studimet ai nuk mund të mos vizitonte pyjet dhe parqet e rrethinave të Parisit, brigjet e plazhet e lumit Sena etj. Por ai ishte edhe një militant komunist që i përqafoi idetë e majta në Francën antifashiste e cila ishte ngritur e gjitha në këmbë për të mbrojtur lirinë dhe demokracinë e kërcënuar nga fashizmi italian, ai fanikist spanjoll dhe nazizmi gjerman.

Në Evropë po frynin erërat e barutit të luftës dhe po buçisnin oshëtimat e artilerisë dhe aviacionit. Gjatë qëndrimit në Francë doktori i ri ka qenë për tetë vjet anëtar i PKF dhe drejtues i komunitetit antifashist shqiptar.

Gjatë qëndrimit në Francë, së bashku me Nako Spirun, Qamil Çelën, Sejfulla Maleshövën, Dhori Samsurin, Gogo dhe Kozma Nushin e shokë të tjerë, ka organizuar protesta të fuqishme në mbështetje të popullit spanjoll kundër rebelimit fashist të Frankos dhe mbështetjes të vullnetarëve shqiptarë që luftonin në Spanjë si: Mehmet Shehu, Skënder Luarasi, Petro Marko, Mane Nishova, Asim Vokshi, Justina Shkupi që ka punuar spitalet dhe infiermeritë me doktor Betynin e famshëm, "Mjekun e tre kontinenteve" e shumë të tjerë.

Ymeri ka pritur e përcjellë vullnetarët shqiptarë për në front. Të parin ndër ta ai ka takuar Petro Markon e më pas edhe të tjerët.

*Një nga aktivistët veteranë të Grupit Komunist të Korçës me kulturë të shëndoshë evropianoperëndimore*

Gjatë ditëve të prillit 1939, kur trupat fashiste italiane pushtuan Sh-



qipërinë, Ymer Dishnica me shokë, emigrantë, punorë dhe studentë shqiptarë që bëheshin disa qindra, organizuan manifestime të fuqishme dhe shkruan pamflete të fuqishme në gazetate dhe revistat e emigracionit shqiptar dhe atij të huaj sidhe botuan në shtypin antifashist francez. Duke qenë një nga aktivistët veteranë të Grupit Komunist të Korçës me kulturë të shëndoshë evropianoperëndimore që mbante lidhje të rregullta me Atdehun, kthehet në Korçë si mjek i kualifikuar por edhe si antifashist me përvojë, hap klinikën e tij mjekësore private para se sa të themelohej PKSh. Në këtë klinikë kryheshin më shumë aktivitete politike antifashiste klandestine dhe takime pune partie me antarët e grupeve atdhetare, se sa vizita mjekësore.

Kishte filluar LANÇ e popullit shqiptar për jetë a vdekje. Shumë shpejt policia sekrete e pushtuesve ra në gjurmët e aktivitetit politik të

doktor Ymerit, kështu ai ishte i detyruar të kalonte në ilegalitet të thellë. Angazhohet në një aktivitet shumë të dendur e të rrezikshëm si kuadër kryesor në veprimtarinë drejtuese të Qarkut të Korçës dhe në këtë kohë u kooptua si antar i KQ të PKSh. Në Konferencën e Parë ANÇ të Pezës më 16.09.1942, Ymer Dishnica si delegat i PKSh, luajti një rol të rëndësishëm organizativ, sidomos në marrëdhëniet e ndërsjellta me personalitetet nacionaliste. Në Pezë ai u zgjodh antar i Këshillit të Përgjithshëm ANÇ të Përkohshëm. Ymer Dishnica gjatë kësaj kohe shpalosi fuqishëm të gjithë talentin e kapacitetet e tij intelektuale dhe organizativo-teorike.

Në Konferencën e Parë të Vëndit të PKSh (1943) u shqua për zotërimin e aftësive oratorike brilante.

Më 4.7.1943 në Labinot të Elbasanit, doktori zgjidhet antar i Shtabit të Përgjithshëm të UANÇSh.

Në mbledhjen e rëndësishme të Mukjes, në muajin gusht të vitit 1943, Ymer Dishnica, Mustafa Gjinihi dhe një delegacion i gjerë përfaqësonte forcat e majta dhe Frontin NÇ, kurse Ballin Kombëtar e krysonte Mitat Frashëri dhe një delegacion po aq i gjerë sa ai i Frontit NÇ. Ata biseduan gjerë e gjatë për problemet e Luftës së përbashkët kundër pushtesit dhe Shqipërisë etnike, çka binte ndesh me synimet e Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugoshës si emisarë të PK Jugosllave dhe J.B. Titos pranë KQ të PKSh që drejtonte Luftën në Shqipëri. Pikërisht për qëndrimin korrekt në këtë mbledhje, u akuzua për oportunitizëm dhe u ndëshkua vetëm doktor Dishnica, ndonëse delegacioni i majtë

përbëhej edhe nga disa personalitete me shumë influencë të LANÇ-it. Ai i qëndroi besnik platformës së miratuar me kohë nga KQ i PKSh. Gjithsesi, LANÇ-i vazhonte e ky personalitet i mençur dhe i shqur i saj, vazhdonte të militonte, tejet i angazhuar, në organet e LANÇ-it. Ai drejtonte sektorët që i ishin ngarkuar dhe së bashku me mikun e tij të zemrës profesor Sejfulla Maleshova, i jepnin gjallëri dhe hare çdo tubimi apo aktiviteti politik të LANÇ-it me qëndrimin e tyre gazmor dhe intelektual. Në Kongresin e Parë Antifashist Nacional Çlirimtar të Përmetit (maj 1944), u zgjodh antar i Komitetit Antifashist Nacional Çlirimtar për shëndetësinë, që kishte atributet e një Qeverie të Përkohshme Popullore. Më 22 tetor 1944, në qytetin e Beratit u emërua ministër i Shëndetësisë i Qeverisë Demokratike të Shqipërisë e cila hyri në Tiranën e çliruar më 28 nëntor 1944.

Paralel me punët dhe aktivitetin e përditshëm që ishte shumë i ngjeshur sepse në Shqipëri po ngrihej gjithçka nga e para në jetën sociale. Së bashku me profesor Sejfulla Maleshövën, doktor Ymer Dishnica, Dhimitër Shuteriqi, poetin Mark Ndoja, publicistin Shefqet Musarai, shkrimtarin Petro Marko por edhe me At V. Prenushin, Andrea Xegën, Dhimitër Paskon, Nexhat Hakiun, Sterjo Spasen, Vedat Kokonën, Se-



laudini Toton etj, një pjesë e të cilëve më pas u burgosën dhe u persekutuan, krijuan për herë të parë në Shqipëri, Lidhjen e Shkrimtarëve dhe morën vendim të botohej revista "Bota e Re", "Letërsia jonë" etj. Kjo bashkësi ishte me prejardhje jo vetëm nga PKSh dhe LANÇ por dhe nga e majta sepse deri atëhere ishte treguar një qëndrim sektar, çka ishte e vërtetë. Pikërisht ato ditë, Sejfulla Maleshova së bashku me doktor Ymer Dishnicën, priten deri në mesnatë, në sallën e kinema Kosovës, shkrimtarin sovjetik me famë botërore Ilia Erenburg, të cilin e shoqëronte dramaturgu fërgjisht folës Hetem Haxhiademi. Por kjo shkëndijë demokracie dhe lirie sociale siç ishte Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë, Sindikatat apo bashkimet Profesionale, Shoqata e Miqësisë Shqipëri-Rusi e cila fillimisht kishte kryetarë: Zëvendëskryeministrin shqiptar gjeneral lejtent Koçi Xoxe, antarin e Byrosë Politike Nako Spiru, Hysni Kapo, Tuk Jakova e të tjerë, u mbyt shumë shpejt nga regjimi diktatorial.

Dr. Ymer Dishnica ishte i papajtuar me diktatorin. Me E. Hoxhën, divergjencat e doktor Dishnicës kishin filluar shumë herët dhe ishin të papajtueshme. Diktatori njerëzit si personalitetet e tipit të Y. Dishnicës, me një integritet dhe pavarësi mendimi shembullore, nuk mund t'i duronte si bashkëpunëtorë, ndaj edhe i eliminoi apo i sakatoi fizikisht një nga një, por nuk mundi kurrë t'i mposhtë moralisht as atëherë kur i burgosi për një kohë të gjatë apo i pushkatoi fizikisht. Doktor Dishnica si rezultat i aktivitetit të tij të jashtëzakonshëm antifashist dhe luftarak, ka qenë i zgjedhur deputet i Kuvendit Popullor që në legjislaturën e parë dhe i nderuar me shumë dekorata urdhëra dhe medalje të RPSH dhe të vendeve të tjera aleate.

## Kalvari i mundimshëm i Dr. Ymer Dishnicës

Në vitin 1947, Ymer Dishnica, për shkaqe thjesht politike, shkarkohet nga detyra e ministrit të Shëndetësisë dhe lihet në dispozicion të ministrisë së Punëve të Jashtme në një punë të dorës së fundit. Me dëshirën e tij, doktori heq dorë përfundimisht nga politika, veshi bluzën e badhë të mjekut patolog dhe filloi punën në spitalin e Tiranës (1948)

dhe punonte si pedagog në shkollën e mesme mjekësore. Më 2 janar 1950, me vendim të posaçëm dëbohet familjarisht nga Tirana për në Berat ku punoi si drejtor i Drejtorisë të Shërbimit Shëndetësor, në spital dhe në ambulancën e qytetit. Në qershor të vitit 1955, për ironi të fatit, me porosi të vetë kreut të piramidës partiake, arrestohet dhe dënohet me gjashtë vjet heqje lirie me akuzën për agjitacion e propagandë kundër shtetit!!! Pas një viti, me ndërhyrjen e njeriut që ndihmoi shumë financiarisht për krijimin e PKSh, xhaxhait të tij Esat Dishnica, i falet dënimi i mbetur (!), por kjo "falje" u shoqëru me një tjetër vendim çnjerëzor të Komisionit të Dëbim-Internimeve. Ky organizëm vrastar stalinisto-enverist e internon doktor Dishnicën në qytetin e Beratit për një afat pesë vjeçar. Y. Dishnica, ndonëse i internuar, pra i persekutuar politik, ishte njeriu më i vlerësuar, më i respektuar nga populli i thjeshtë i qytetit dhe pacientët e tij të shumtë. Gjithsesi, ai mbeti familjarisht atje ku ishte, i izoluar dhe i mbikqyruar ashpër nga organet e Sigurimit të Shtetit, deri në kohën e përmbysjes të diktaturës së Enver Hoxhës dhe klikës së tij. Doktor Dishnica, ndërkohë ishte shumë i kujdeshëm, studioje dhe lexonte literature profesionale të përparuar të kohës, por edhe i ndiqte me vëmendje e kujdes situatat politike të kontinentit. Ai, gjithsesi e ndjente shpresën e madhe të demokracisë dhe liria politike dhe sociale, e cila me gjithse me shumë vonesë, po vinte më së fundi edhe në Shqipëri.

Personaliteti i madh shqiptar Y. Dishnica, mundi më së fundi të kthehet i lirë në Tiranë në vitin 1995, i lodhur por optimist. I përndjekur, por i pa përkulur nga shtypja e gjatë.

Në vitin 1994, me gjith moshën jo të re, zgjidhet kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar.

I nderuari Y. Dishnica vdiq në gjirin e familjes i qetë dhe i respektuar nga familjarët, të afërmit, miqtë, shokët, veteranët dhe luftëtarët e LANÇ-it më 22.9.1998. Shoqëria shqiptare humbi kështu një njeri emblematik, të edukuar, të shkollur, të përkushtuar dhe të kulturuar në shkallën më sipërore që do të kujtohet për një kohë shumë të gjatë dhe do të zerë vendin e merituar në panteonin e nderit të kombit shqiptar.

Presidenti Nishani dekreton emërimin e znj. Mimi Kodheli, ministër i Mbrojtjes

# Mimi Kodheli, ministrja e re e Mbrojtjes

Më 11 shtator 2013, me propozimin e kryeministrit Edi Rama, Presidenti i Republikës Bujar Nishani dekretoi emërimin e znj. Mimi Kodheli, Ministre e Mbrojtjes. Ajo ka lindur në Tiranë më 11 shtator 1964. Ajo është e martuar me Lekën dhe kanë një djalë, Mikelin. Znj. Kodheli është Doktorante e Shkencave Ekonomike nga Universiteti i Veronës, Itali, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, prej vitit 2007. Ka një Master në Administrim Biznesi nga Universiteti i Lincoln, Nebraska, SHBA në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës prej vitit 2000 si dhe është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Dega Financë në vitin 1986. Znj. Mimi Kodheli ka hyrë në politikë në vitin 2002, kur edhe u bë Nënkryetare e Bashkisë së Tiranës. Në vitin 2005, ajo u emërua Prefekte e Qarkut të Tiranës dhe në vitin 2009 u zgjodh Deputete e Kuvendit të Shqipërisë duke mbajtur pozicionin e Nënkryetares së Komisionit të Ekonomisë dhe Financës së Komisionit të Ekonomisë dhe Financës përgjatë gjithë legjislaturës. Që prej vitit 2007 e në vazhdim është Anëtare e Kryesisë së Partisë Socialiste. Ajo është trajnuar në fusha të ndryshme si ato të tregjeve ndërkombëtare dhe të letrave me vlerë, tregjet e punës dhe të investimeve, trajnim për ndërmarrjet të vogla e të mesme, ekzaminim dhe menaxhim bankar. Ajo ka marrë pjesë në një program të Departamentit Amerikan të Shtetit të titulluar "Gratë në Politikë" si dhe atë të titulluar "Politikat e Sigurisë Kombëtare"- Qendra Europiane e Sigurisë, Marshall. Znj. Kodheli zotëron gjuhën angleze dhe italiane, si dhe njeh mjaftueshëm gjuhën frënge dhe spanjolle.

**DEKRET  
PËR  
EMËRIM MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

**D e k r e t o j**

**Neni 1**

Zonja Mimi Kodheli, emërohet Ministër i Mbrojtjes.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. Dekretit 8307  
Tiranë, më 11 shtator 2013**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
BUJAR NISHANI**

Mimi Kodheli gjatë legjislaturës së kaluar ishte anëtare e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvendin e Shqipërisë.

"Unë isha njësoj e surprizuar si të tjerët" është shprehur Mimi Kodheli, ditën që është përzgjedhur nga kryetari i partisë së saj, Edi Rama, si ministrja e re e Mbrojtjes.

Ekonomistja 49-vjeçare deri më tani është marrë në parlament me çështjet të buxhetit të ushtrisë. Tani, në qeverinë e dominuar nga socialistët, ajo do të jetë një shembull se si Shqipëria patriarkale po bën një hap drejt barazisë gjinore.

Kodheli është mësuar me betejat në domenet e meshkujve. Në zgjedhjet e 23 qershorit ajo garoi në Lezhë, në veri të Shqipërisë ku ka 'njerëz të armatosur, papunësi të lartë dhe kriminalitet'. 'Njerëzit atje janë të

vëmendshëm kur aty është një grua për shkak se ajo përfaqëson njëfarë kompensimi," thotë ajo.

Shumë do e shohin atë si Zonjën e Hekurt. "Por unë nuk e shoh kështu," thotë ajo. Faktin që tani do marrë përsipër dikasterin e mbrojtjes, e sheh si pjesë të emancipimit.

Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe kjo aleancë është shumë popullore në vend për shkak të luftës në Kosovë. Gjithashtu Shqipëria ishte pjesë e aleancës së George Bush në luftën e Irakut.

Ajo është në politikë që prej 13 vitesh. Në kohën e lirë ajo qëndron me dëshirë në shtëpi "për shkak se unë kam kaq pak kohë", thotë grua, që është krenare për karrierën e saj, "por kryevepra ime është djali im 24 vjeçar".

Më 2 shtator, Znj.Kodheli mori



ishte në Bazën Detare të Pashalimanit ku u zhvillua "Dita e Vizitorëve të Shquar" të stërvitjes së koduar "Albanian Lion 2013". Kjo stërvitje u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit midis FA të Shqipërisë dhe FA të Mbretërisë së Bashkuar. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin: presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, ish ministri i

Mbrojtjes, z. Arben Imami, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, Komandanti i FSK, gjenerallejtënant Kadri Kast-rati, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në vendin tonë, z. Nicholas Cannon, si dhe personalitete të tjera politike dhe ushtarake.

## Fillon viti i ri akademik në Akademinë e Forcave të Armatosura

Më 09 shtator 2013, në sallën e auditorit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) u zhvillua ceremonia e hapjes së vitit të ri akademik 2013-2014. Viti akademik ushtarak përfshin Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Kursin e Lartë të Oficerit, Kursin e Komandës së Shtabit të Përgjithshëm, Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Viktor Berdo, ambasadori i Greqisë, z. Leonidas Rokanas, atashetë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të zyrës së CUBIC dhe ODC, gjeneralë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, si dhe të ftuar të tjerë.

Fjalën e hapjes në këtë ceremoni e mbajti komandanti i KDS, gjeneral brigade Bardhyl Hoxha. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm,

gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, në fjalën e tij u shpreh se, ceremonia e hapjes së vitit akademik në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe institucionet e tjera të arsimimit ushtarak është një ngjarje e shënuar për të gjithë ne. Kjo lidhet direkt me një nga prioritetet tona kryesore që ka të bëjë me arsimimin dhe kualifikimin e personelit me dije dhe informacion bashkëkohor, aq të domosdoshëm në sfidat dhe përgjegjësitë me të cilat përballemi aktualisht dhe në të ardhmen. "Një numër programesh startojnë sot në institucionet arsimore të KDS, dhe mozaiku i tyre përfshin gati të gjitha nivelet e arsimimit dhe kualifikimit në FA, për personelin ushtar, nënoficer, oficer dhe civil, që shërben në Forcat e Armatosura dhe institucionet e tjera të sigurisë. Ndaj me këtë rast, ju përhëndes dhe ju uroj një fillim sa më të mbarë! Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm dhe unë personalisht, besojmë se

prania e një audience të zgjedhur të përbërë nga pjesëmarrës, ekspertë vendas, si dhe lektorë të shquar nga vendet aleate e rajoni, do të jetë me siguri një vlerë e vërtetë e këtij kursi, si dhe do të shërbejë për inkurajimin e bashkëpunimit rajonal, integrimin e gjithë rajonit në të ardhmen, çuarjen përpara të shpirtit të mirëkuptimit, ndërtimit të besimit në vlerat e paqes, lirisë dhe sigurisë së përbashkët", - është shprehur gjeneralmajor Gjunkshi.

Më tej, gjeneralmajor Gjunkshi ka shprehur bindjen e tij se, oficerët që do të ndjekin këtë vit kurset në Akademinë e Forcave të Armatosura do të pasurojnë më tej dijet e tyre nëpërmjet shkëmbimit të përvojës dhe mendimeve, si edhe do të kenë mundësinë të krijojnë vlera profesionale dhe miqësore, të cilat do të jetojnë gjatë edhe pas përfundimit të tyre. Me këtë rast ai ka falënderuar për mbështetjen dhe besimin, ministrat e Mbrojtjes dhe

shefat e Shtabit të vendeve që dërguan pjesëmarrës në këtë kurs, si dhe të gjithë akademikët e Kursit të Lartë të Oficerit, Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit. Gjithashtu, ai ka kërkuar prej tyre angazhim dhe përkushtim maksimal për përvetësimin e programit, por edhe për të sjellë në auditorët e Akademisë eksperiencën e tyre të çmuar nga raportet dhe njësitë ku shërbejnë.

Akademia e Forcave të Armatosura përfaqëson nivelin më të lartë të arsimimit dhe kualifikimit në Forcat tona të Armatosura. Në këtë Akademi zhvillohen kurset institucionale si Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit, Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, Kursi i Lartë i oficerit, si dhe Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen. Zhvillohen gjithashtu dhe programe mastër profesional, mastër shkencor dhe doktoraturë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes ka filluar për herë të parë si Kolegj i Mbrojtjes, në vitin 1995. Nga viti 2007, Kolegji i Mbrojtjes kthehet në Kurs i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM) me pjesëmarrje të gjerë të ushtarakëve edhe nga vendet e rajonit. Aktualisht, në këtë kurs marrin pjesë ushtarakë nga Turqia, Rumania, Kroacia, Greqia, Azerbajxhani, Kosova e Maqedonia. Pjesëmarrës të kurseve të mëparshme kanë qenë ushtarakë nga Italia, Mali i Zi, Bosnja Hercegovina, Serbia etj.

Qëllimi i këtij kursi është përgatitja e drejtuesve ushtarakë dhe civilë të pajisur me mirëkuptimin dhe vendosmërinë e nevojshme për t'u ballafaquar dhe për t'u dhënë zgjidhje ndryshimeve dinamike që kërkohen në strukturat e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare dhe Ndërkombëtare, për të dhënë kontributin e tyre në përbalimin e sfidave të ardhshme të sigurisë.

# NJË HISTORI LAVDIE E MIQËSISE SHQIPTARO AMERIKANE

Mal Berisha

**R**enja e avionit amerikan C53 D me datë 8 nëntor 1943 shënoi rastin e parë dhe të fundit në historinë e Luftës së Dytë Botërore që një ekip infermierësh, ushtarakësh dhe pilotësh amerikanë të rrëzoheshin me avion në një zonë të okupuar naziste gjermane dhe të shpëtonin. Kjo ndodhi në Shqipëri.

## SHQIPTARI MIKRPITËS:

Ka shumë kombe në botë të cilët krenohen për cilësitë e tyre. Dikush për letërsinë, dikush për muzikën, dikush për industrinë dhe shpikjet e mëdha, dikush për luftërat dhe strategjet...

Historia ka kultivuar tek secili komb dicka të vecantë që e bën atë më unik, më të respektuar ose ndoshta edhe më pak të respektuar...

Ne shqiptarët krenohemi për besën kur ka kombe tjera që krenohen për pabesinë; Krenohimi për mikrpijtjen kur ka popuj banorët e të cilëve po t'ju trokasë dikush në derë, thërrasin policine, ndërkohë që ne shqiptarët e hapim derën dhe i japin strehë, bukë e ndihmë jo vetëm mikut, por edhe të panjohurit, madje edhe pse kjo mund të kërkojë sakrificë të mëdha deri në rrezik jete ose flijim...

Pikërisht një virtut kaq i mrekullueshëm i shqiptarëve ka bërë që në historinë e vonë të kohës së Luftës së Dytë Botërore shqiptarët të rregjistrojnë ngjarje nga me interesantet, më të bukurat, më humanet, më njerzoret dhe më të mahnitshmet në vetë historinë e njerëzimit të asaj kohe. Janë ngjarje të cilat janë realizuar dhe mbajnë autorësi kolektive dhe janë kryer nga njerëzit e thjeshtë të popullit shqiptar që nuk kanë

tashmë e njohur thujse nga të gjithë jo vetëm në Shqipëri (madje ndoshta më pak në Shqipëri) por edhe jashtë e sidomos në ShBA, Izrael dhe në përgjithësi në botën hebreje ane e mbane botës. Kjo është historia e mrekullueshme e Shpëtimit të Hebrejve në Shqipëri, jo vetëm të atyre që ishin banorë dhe hebrej shqiptar por të qindra në mos mijëra të tjerëve të cilët të vënë përpara alternativës së vdekjes ose jetës, zgjodhën Shqipërinë si i vetmi vend në Europë ku mund t'i shpëtonin Hollokaustit. Shqipëria ishte zgjedhja e tyre për jetën duke sfiduar kështu vdekjen me rrezikun që shqiptarët morën mbi vete.

Historia e fisnikëvë shqiptarë në të vërtetë ka lozur dhe po luan një rol shumë të madh jo vetëm në mardhënjet me shtetin e Izraelit por më shumë se kaq në ndihmesën që lobet hebreje kudo në botë dhe veçanërisht në ShBA japin për mbarëvajtjen e punëve të kombit shqiptar si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë dhe Maqedoni. Por shpëtimi i hebrejve nuk përbën të vetmin rast kur shqiptarët kanë shpalosur virtytin e tyre të mikrpijtjes dhe respektit për të huajin...

## 8 NËNTOR 1943, AEROPLANI USHTARAK AMERIKAN C 53D ME 30 VETË RRËZOHET NË PESH-TAN, BERAT.

Me 8 nëntor 1943 një ngjarje e zakonit për Luftën e Dytë Botërore por e pazakonte për dëgjuesin e sotëm futi në analet e historisë së mardhënjeve Shqipëri - Amerike njerën nga ndodhitë më interesante, më të habitshme më dramatike, më të shkëlqyera por edhe me fundin më fatlum, falë virtytit shqiptar të besës



erësh, ushtarakësh dhe pilotësh amerikanë të rrëzoheshin me avion në një zonë të okupuar naziste gjermane dhe të shpëtonin. Kjo ngjau pikërisht në Shqipëri dhe u pasua nga një sagë dy mujore përpjekjesh për të shpëtuar në një udhëtim të pashembullt në këmbë ose me mushka nëpër fshatrat jugore nga Peshtani i Beratit deri në Korçë e kthim në Gjirokastrë dhe Vlorë.

## "ZBARKIMI" I SUPOZUAR I TRUPAVE ALEATE NË SHQIPËRI

Aeroplani C53D i cili do të transportonte Njësinë Mjekësore 807 të Evakuimit Ajror që vepronte në prapavi u nis nga Catanja, Itali për të aderuar në Bari. Fluturimi filloi në orën 09.00 të mëngjesit me 30 vetë në avion. Pas një nisje të qetë dhe të

vetëm një ka-zgjedhe të cilin të zotët e sakrifikuan për miqtë, pa asnjë shpërblim. Pas dy ditë qëndrimi turma e amerikanëve bëri një hyrje "spektakolare" në qytetin e Beratit, i cili ishte nën kontrollin gjerman. Këta njerëz të dëshpëruar në fillim u morën si pjestarë të forcave aleate dhe tërë qyteti u gëzua për "zbarkimin" e tyre. Por shpejt gëzimi i ardhjes së tyre u shua dhe vendin e tij e zuri kujdesi njerëzor i manifestuar në këtë qytet edhe për të huaj të tjerë e veçanërisht për hebrejtë e asaj kohe që po ashtu ruheshin nga gjermanët. Qyteti ishte kthyer në një strehë për hebrejtë që po mblidheshin nga vende të ndryshme të Europës. Pas disa ditësh në qytet, të frikësuar se mos zbuloheshin nga gjermanët dhe të ndihmuar nga banorët e qytetit ata u larguan thujse nëpër këmbët e gjermanëve për në jug të qytetit drejt Malit të Tomorrit. Një pjesë e tyre e vogël u nda nga turma dhe u detyrua të mbante drejt tjetër.

Udhëtimi i tyre kap një trajktore të gjatë prej afro 1300 kilometra rrugë, ose sa të shkohet nga Tirana në Izmit të Turqisë në këmbë duke kaluar nga fshatrat e Beratit në ato të Skraparit, deri në lartësitë e Malit të Tomorrit, Vërzhezhe, Leshnjë, Lovdar, Krushevë, Lumin Osum, Malind, Odriçan, Përmet, Lumin Vjosa, Malin e Nëmërcëkës, më pas në Korçë, Voskopojë dhe kthim drejt Gjirokastrës, Sheper, Mashkullorë, e më pas drejt Kuçit dhe duke kaluar në bregdet drejt Dhermiut, Vunoit, Dukatit, Tërbaçit në gjirin e Elefantit në Karaburun nga ku ata me ndihmën e shërbimeve të fshehta angleze arritën të ktheheshin në Itali.

## UDHËTIM BIBLIK I AMERIKANËVË NËPËR SHQIPËRINË E JUGUT

Miqtë amerikanë kishin rënë në fshatin Peshtan (Prashtan) dhe aty u vendosën në një shtëpi e cila me gjithë varfërinë e madhe që kishte, i strehoi dhe i ushqeu. Amerikanët panë me sytë e tyre një varfëri ekstreme dhe një jetë të vështirë por edhe virtytin e këtyre njerëzve. Për të ushqyer tridhjetë vetë mjaftonte



asnjë lidhje me një orientim fetar, politik, social, etj. Njëra nga... është bërë

dhe mikrpijtjes... Kjo ngjarje shënoi rastin e parë dhe të fundit në historinë e Luftës së Dytë Botërore që një ekip infermi-

zakonshme piloti hasi në një mot të keq i cili ngriu krahët e avionit duke e vështirësuar drejtimin e avionit. Për orë të tëra ata u sollën sa mbi Itali sa mbi Detin Adriatik dhe më

Kjo ngjarje kaq interesante mbeti e patreguar për vite të tëra jo vetëm në Shqipëri por madje edhe në



Amerikë. Kronikanja e ngjarjes, infermerja Agnes Jensen, e cila vdiq para dy vjetësh në moshën 95 vjeçare në shtetin Kentucky në ShBA, thotë se deri në vitin 1985 nuk e e tregon-te ngjarjen ose e tregonte në rrethe shumë të ngushta pasi kishte dëgjuar se njerëzit që i kishin ndihmuar atyre, pas luftës ishin ndëshkuar rëndë; disa ishin pushkatuar, disa internuar ose izoluar politikisht. Pas vdekjes së diktatorit shqiptar, 1995, thotë se filloi ta tregonte ngjarjen dhe në vitin 1995 ajo i botoi kujtimet në formën e një tregimi luftime të mbushur me aq shumë përshkrime interesante ku jipet një tablo e pakrah-sueshme e realitetit shqiptar të kohës së luftës. Zonja Jensen ngre lart vlerat e popullit shqiptar dhe në mënyrë tepër unike ajo spegon se si këta 30 njerëz në rrezik, bij të kombit të madh amerikan, në ditë të vështira të jetës së tyre, të kërcenuar sa nga gjermanët aq edhe nga vështirësitë e dimrit, urija, izolimi dhe skamja u pritën dhe u mbrojtën nga shqiptarët e varfër. Ata u mbrojtën, strehuan, ushqyen njësoj mire, si nga partizanët ashtu edhe nga ballistët shqiptar, tregon Agnes Jensen.

**SHQIPËRIA SIPAS ASAJ QË DINTE AGNES JANSEN**

Në vitin 1943 Shqipëria konsiderohej vendi më i varfër dhe më i prapambetur në Europë. Tre të katërtat e 28.000 kilometrave katrore të këtij vendi përbëhen nga një terren malor me përrenj të panumërt si dhe pesë lumenjë kryesor që e ndajnë vendin në disa zona. Jul Qezari në vitin 48 para erës së re komentoi në zhurnalin e tij se kalimi i lumenjëve ishin pengesat kryesore për ushtrinë e tij romake. Përkrah vijës së ultë dhe të rrezikshme bregdetare kishte vetëm një gji të sigurtë dhe një port, që të dy nën kontrollin nazist në dimrin e vitit 1943 - 44. Me vetëm 26 milje rrugë të shtruara në Shqipëri të shumtët e njerëzve udhëtonin në këmbë ose me kafshë. Vetëm ca shtëpi kishin elektricitet ose ujë të rrjedhshëm brenda dhe ushqimi ishte i pamjaf-tueshëm. Për personelin e njësisë ajrore të evakuimit mjeksor i cili u nis për një mission rutinë, ulja e paplanifikuar në Shqipëri duhet të jetë dukur si rënja e një pike loti mbi perden e errët të kohës.

Kushdo që do të kurthohej në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore siç ndodhi me ne, do të ballafaqohej jo vetëm me ashpërsinë e motit dhe topografinë e thyer por edhe historinë e komplikuar dhe shpesh brutale të këtij kombi të pushtuar.

Do të ishte e pamundur të udhetohej nëpër atë vend dhe të mos hasëshe në çdo hap në historinë e tij. Sigurisht që kjo është e vërtetë për pjestarët e ekipit të forcave ajrore të ushtrisë Amerikane dhe pasagjerëve të atij avioni të cilët u rrëzuan në atë nëntor 1943 dhe

që luftuan për dy muaj për të arritur në zonat e sigurta aleate. Si një vend në kryqëzimet gjeografike të shumëkulturve, Shqipëria ka patur një të kaluar kaledioskopike duke iu alternuar kufinj të, fetë dhe gjuhët në përgjigje të trajtimit agresiv të ndërmarrë prej fqinjëve të saj të më të fortë dhe ambiciozë. Fillimisht e identifikuar si shoqëri fisnore e kohës së bronxit, shqiptarët, luftëtarë të paepur, u ruajtën në rrjedhë të shekujve nga dominimi grek dhe romak dhe valë pas vale pushtimeve të visigotëve, hunëve, ostrogotëve, sllavëve, serbëve, dhe normanëve. Pas afro pesë shekujsh sundimi turk, Shqipëria doli në epokën e pas luftës së Parë Botërore me një dëshirë për vetqeverisje por me një popullatë të goditur rëndë nga varfëria, analfabetizimi, dhe dallimet fisnore, fetare që kanë provuar të jenë pengesa në rrugën e unitetit kombëtar dhe bashkë-ekzistencës paqësore. Ndonëse Shqipëria e shpalli pavarësinë në vitin 1912, qeveria kombëtare e dale prej saj nuk arriti të bentë më të mirën për vendin e vet për shkak të luftës botërore. Ushtritë e huaja e push-tuan ose kaluan nëpr territorin e saj. Grekët dhe italianët kishin qëllim ta ndanin Shqipërinë nëpërmjet të Traktatit të Fshehtë të Londrës në vitin 1915 i cili u ndalua të zbatohet nga Traktati i Versajës falë mbështetjes së fortë që Presidenti Amerikan Uillson i bëri pavarësisë së Shqipërisë. Italia ndoqi Greqinë në tërheqjen nga Shqipëria. Kur Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve përpjekjet për stabilitet sikur u përmbushën.

Duke kaluar mëse dy muaj nëpër Shqipëri në kushtet më të vështira të imagjinueshme, ajo mëson edhe se çfarë mendojnë shqiptarët për Amerikën:

**DASHURIA PËR PRESIDENTIN UILLSON NË MAJET E MALEVE ME DËBORË.**

Në një bisedë më njërin nga shqiptarët, i quajtur Stefa, autorja pyet se a kishte ndonjë arsye pse shqiptarët e kishin një dëshirë kaq të madhe për t'i ndihmuar ata, amerikanë të braktisur nga fati, dhe pse u gëzuan kur na panë që erdhëm dhe na morën si aleatë që po zbarkonim:

Dhe Stefa i përgjigjet: Populli ynë ka pritur një kohë të gjatë që amerikanët të na dërgojnë ndihma që ne pastaj të luftonim më mirë kundër gjermanëve. Kur u përhap fjala se ju keni ardhur, njerëz menduan se zbarkimi i amerikanëve kishte filluar.

"Populli im e ka parë gjithmonë vendin tuaj me respekt për qëndrimin që mbani ndaj demokracisë", i tha Stefa. "Ne madje kemi edhe një qytet me emrin "Porti Uilson" në nderim të njërit prej presidentëve tuaj."

"A ka një arsye të caktuar që ju



keni zgjedhur Presidentin Uilson" pyeti Vilma?

"Ai ishte i vetmi person i cili foli për Shqipërinë në Konferencën e

duhet të jemi dukur si një hordhi karkalecash kur zbrsnim nga një fshat i tyre në tjetrin. Jam e sigurtë se në të shumtën e rasteve ata na kanë

kishin kaq pak për vete janë të gatshëm të rrezikonin kaq shumë për tridhjetë njerëz që nuk i njihnin dhe as që e dinë dhe as që presin në se



Paqës në Paris kur dukej se vendi ynë do të ndahej midis Greqisë dhe Jugosllavisë pas Luftës së Parë. Ne madje e ndjemë se ai e kuptonte edhe dëshirën e një kombi të vogël për liri."

**MË TEJ AGNES JENSEN SHKRUAN:**

Është absolutisht e mahnitëshme se si këta njerëz do të ndanin atë pak gjë që kishin për vete, tha Jens. Ne

ushqyer me ato ushqime rezervë të mbledhura për të kaluar dimrin. A mund të imagjinoni tridhjetë vetë që të shfaqen tek dera e shtëpisë në Amerikë që kërkojnë ushqim i cili është vënë menjëanë për familjet e tyre.

Shtoi këtu edhe shansin për tu ekzekutuar për dhënjën ndihme këtyre njerëzve dhe strehimin. Është një mrekulli që këta shqiptarë të cilët

ndonjë herë në këtë jetë do ti shihnin përsëri.

Kjo histori është botuar në librin ALBANIAN ESCAPE shkruar nga infermerja, pjestare e këtij ekipi, Agnes Jansen Magerich. Libri mund të gjëndet në Amazon.com

Në adresën: Albanian Escape: The True Story of U.S. Army Nurses Behind Enemy Lines by Agnes Jensen Mangerich (31 Jul 1999)

# Vetëdija historike dhe identiteti europian i Kosovës

**Nga Enver Hoxhaj  
ministri i Jashtëm i Kosovës**

## DY NGJARJE DHE NJË KREMTE

Para pak ditësh në Kosovë u hap ekspozita e hartave romake të antikës së vonë; ndërkohë u organizua dhe një simpozium ndërkombëtar me rastin e 1700-vjetorit të Ediktit të Milanos. Në këto ngjarje, krahas rolit qendror që kishte Ipeshkvia e Kosovës dhe institucionet e tjera shkencore, Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës ishte po ashtu bashkorganizatore e tyre. Ngjarja më kulmore ishte, kremte e së enjtes më 5 shtator, kur edhe u mbajt mesha për nder të dhjetëvjetorit të Lumturimit të Nënë Terezës. Kjo ishte një javë jubilarë, e cila flet për shtratin historik dhe kulturor, për kulturën institucionale dhe për orientimin tonë europian. Konstantini i Madh ishte ndër perandorët më me ndikim të Perandorisë së vonë Romake.

Ai solli rikthimin e fuqisë së saj politike dhe ringritjen e saj morale në një kohë kur ajo po jepte shenja serioze të shpërbërjes së saj. Vendimi i tij, i njohur si Edikti i Milanos, i vitit 313, përmes të cilit ai e dekretoi lirinë e besimit të krishterë, që deri atëherë ishte i ndaluar dhe i përndjekur, që paraqet ngjarje kthesë për Kishën dhe të kulturën perëndimore. Ky vendim e zyrtarizoi krishterimin në këtë perandori dhe e bëri atë të barabartë me fetë të tjera. Shumë shekuj më vonë, gjegjësisht në shekullin 20, një grua, e cila në rini përqafoi udhën e mistikëve të mëdhenj, e ndryshoi në themel stilin dhe veprimtarinë e të qenit misionare. Ajo ishte Nënë Tereza, e cila e bëri për mision të saj mbështetjen e të varfërve, të braktisurve dhe popujve të shtypur. Në shekullin e kaluar pak personalitete kanë ndikuar si ajo nën petkun religjioz dhe shoqëror si Nënë Tereza. Ajo është radhitur ndër personalitetet më të vlerësuar botërore, sikurse Mahatma Gandhi, Martin Luther King apo Nelson Mandela. Për këtë, më 17 tetor 1979, Komiteti Norvegjez bëri të ditur në Oslo se çmimi për Paqe i ishte ndarë Nënë Terezës.

## KUJTESA DHE IDENTITETI

Figura historike e Konstantinit të Madh dhe personaliteti botëror i Nënë Terezës kanë qenë objekt humlumi në një numër librash, studimesh e shkrimesh publicistike ndërkombëtare. Për këtë arsye nuk do ndalem në një editorial si ky në ripërsëritjen e të dhënave biografike apo fakteve historike të kohës. Këtu unë synoj vetëm të jap disa refleksione personale rreth trashëgimisë së tyre historike dhe kulturore, e cila është një vlerë e përbotshme për njerëzimin. Për më shumë, kjo trashëgimi është një vlerë e veçantë edhe për Kosovën; ajo është pjesë e kujtesës sonë historike dhe e identitetit tonë europian. Kujtesa historike është një manifestim shoqëror shumë kompleks, e cila krijohet dhe rikrijohet disa herë në kriza, konflikte dhe luftëra. Shpeshherë ajo e ruan substancën, por mund ta humbë formën, dhe e kundërta.

Po ashtu, identitetet e popujve bëhen dhe ribëhen në procese kthesash të mëdha historike, duke ruajtur emrin, përmbajtjen dhe shfaqjen e jashtme apo duke i humbur të gjitha. Për shkak të karakterit kompleks të kujtesës historike dhe të identitetit, këtu do përmend vetëm

disa elemente historike dhe aspekte kulturore, të cilat e japin edhe thelbin e peshës politike të kësaj trashëgimie dhe, si të tilla, shndërrohen në përbërës të identitetit tonë. Por së pari duhet ta kuptojmë më mirë se përse këto dy figura historike paraqesin referenca të vazhdimësisë sonë historike dhe kulturore. Së pari, do përmend këtu gjeografinë e vendlindjes së tyre. Për Konstantinin e Madh historianët antikë dëshmojnë se qyteti dardan Naisus ishte vendlindja e tij. Ndërsa Gonxhe Bojaxhiu, që më vonë mori emrin Nënë Tereza, lindi më 1910 në një familje shqiptare nga Prizreni i Kosovës, të familjes së Nikollë (Kolë) Drane Bojaxhiut. Gjeografia antike e përcaktonte provincën romake të Dardanisë si pjesë të Ballkanit Qendror; gjeografia moderne e përcaktonte Kosovën si vend me pozitë qendrore në Europën Juglindore.

Gjeografia si një fakt i dhënë dëshmon identitetin europian të Kosovës, e cila është e rrethuar edhe nga shumë vende të tjera europiane, si Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia. Të gjitha këto vende e kuptojnë veten si europiane, dhe kjo vlen edhe për Kosovën. Disa nga fqinjët e tyre tashmë janë bërë anëtarë të Bashkimit Europian, si Greqia, Bullgaria, Rumania dhe së fundi edhe Kroacia. Së dyti, si aspekt me rëndësi është origjina e tyre. Mendimi shkencor bashkëkohor i sheh shqiptarët si pasardhës të ilirëve dhe krahas latinëve, gjermanëve dhe keltëve, si një ndër popujt më të vjetër në kontinentin europian. Fakti historik që Konstantini i Madh ishte me origjinë ilire nga Dardania e bën atë pjesë të kujtesës sonë historike. Sa i përket Nënë Terezës, në një libër të botuar nga Vatikani dhe përdorur në ditën e ceremonisë të Lumturimit të saj, më 19 tetor 2003, thuhet: "Me gjak jam shqiptare, sipas thirrjes i përkas botës, dhe sa i përket besimit, jam murgëshë katolike". Së treti, është gjuha e Konstantinit të Madh, gjuha latine. Burimet e kohës antike e përmendin origjinën dardane, por askund nuk ka të dhëna që ai të ketë folur ndonjë dialekt gjuhësor të preardhjes së tij.

Sido që të jetë, Dardania antike i ka tukur arealit kulturor latin dhe latinishtja ka qenë e përhapur si në shumë provinca të tjera romake. Por nuk ka dyshim që në kuadër të letërsisë së hershme shqipe në Kosovë, si dhe kudo në viset e tjera shqiptare në Ballkan, është shkruar në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën latine. Elitat e kohës kanë përdorur paralelisht në komunikimet dhe shkrimet e tyre të dyja gjuhët deri në shekullin e 18-të në tërë territorin e Kosovës, sikurse është fjala për shkrimet nga Pjetër Budi të Pjetër Bogdani. Kështu, shqiptarët si ndër popujt e rrallë të rajonit, përdorën në kontinuitet një kohë të gjatë shqipen dhe gjuhën latine. Kur një grup intelektualësh në Kongresin e Manastirit, më 1908-n, dhe nën udhëheqjen e Gjergj Fishtës dhe Mit'hat Frashërtit, në prag të shpërbërjes së Perandorisë Osmane morën vendim për alfabetin latin të gjuhës shqipe, kjo ngjarje ishte kumt i fillimit të rikthimit në Europë. Por, në të njëjtën kohë ishte një ngjarje kontinuitet i arealit latin gjuhësor dhe kulturor të shqiptarëve në histori. Zyrtarizimi i alfabetit latin fliste në atë kohë për përkatësinë tonë europiane dhe tregon edhe sot për orientimin tonë europian. Së

katërti, Konstantini i Madh me Ediktin e Milanos ishte ideator i lirisë si koncept, i lirisë individuale dhe kolektive. Natyrisht, shumë kohë para tij liria politike kishte qenë e njohur për shumë popuj dhe përcaktuese e rrjedhës së tyre. Mirëpo, me Ediktin e Milanos liria fetare si koncept i ri u bë përcaktuese e një emancipimi dhe zhvillimi shoqëror të popujve dhe ajo fitoi një dimension të ri. Edhe Nënë Tereza disa shekuj më vonë, kur bota ishte e ndarë përmes Luftës së Ftohtë, ideologjive e diktaturave, do të përkushtohej për rikthimin e dinjitetit njerëzor të individëve. Në vitet dramatike të fundit të regjimit komunist në Shqipëri dhe shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë, Nënë Tereza do të shndërrohet në simbol të aspiratës për liri të shqiptarët dhe si frymëzim i përhershëm për rikthimin tonë në Europë. Një aspekt i pestë i këtij Edikti është se ai paraqet akt të tolerancës ndërfetare me të cilin para 1700 vjetësh u shpall krishterimi në mes e feve të tjera si fe e barabartë. Para se të bëhej publik ky vendim i zyrtarizimit të kësaj feje, krishterimi ishte përhapur ndër ilirët që në periudhën e hershme të tij. Në qytetin dardan të Ulpianës që herët do të paraqiten martirët e parë të krishterë Flori dhe Lauri dhe një kishë dardane me një rrjet të mirëfilltë institucional do të jetë pjesë e shoqërisë antike të kohës. Katedralja me emrin e Nënë Terezës ngritur në mes të kryeqytetit të Kosovës është dëshmi e lartësisë dhe idesë së harmonisë ndërfetare të bartur në shekuj deri më sot. Dhe kur sot shteti i Kosovës është i ndërtuar në tri parimet e mëdha - demokracia, multietniciteti dhe sekularizmi - që të tria këto refleksione të shtratit kulturor europian. Kodi zakonor i shqiptarëve të veriut është pothuajse i njëjtë me thelbin dhe misionin e tij me traditën e njëjta të popujve europianë të mesjetës. Kur për herë të parë kam lexuar Nibelungen në gjuhën gjermane, aty ka elemente të cilat të rikujtojnë situata të eposit gojor shqiptar.

Kur në fillimet e kohës moderne paraqitet përkundër një vonese lëvizja kombëtare shqiptare, ajo ishte e formësuar dhe ndërtuar në konceptet europiane të humanizmit, iluminizmit dhe romantizmit të kohës. Programi i saj politik, qeverisës dhe kulturor ishte europian, siç edhe reflekton fuqinë e tyre Sami Frashëri, si ideolog i saj. Programi kombëtar i asaj kohe ishte një nacionalizëm laik dhe ideja e prejardhjes ilire, i gjuhës së saj indoeuropiane dhe i territorit historik të banuar nga shqiptarët do të bëhen përcaktues të identitetit kombëtar. Në këtë drejtim, harmonia fetare dhe jeta në një peizazh multietnik, multikulturor dhe multifetar kanë qenë në funksion të interesit afatgjatë dhe lirisë. Kështu, identiteti kombëtar si element i përkatesisë së përbashkët do të jetë mbi tri fetë e tjera dhe një shqiptar i besimit mysliman do të jetë po aq europian sa edhe një shqiptar i besimit katolik apo ortodoks. Natyrisht që ka edhe aspekte të tjera, të cilat do të duhej të merreshin në konsideratë për ta kuptuar këtë përvojë historike.

Këtu dua të përmend një të fundit. Edikti i Milanos është po ashtu edhe një edikt i paqes dhe Nënë Tereza, një misionare e paqes dhe e humanizmit. Misioni i tyre është dhe mbetet pikë referimi për mbarë shqiptarët dhe gjithë popujt e tjerë të



botës, të cilët te Konstantini dhe Nënë Tereza shohin themelarin e paqes dhe të simbolin vijon nga faqja 1 e vlerave të larta humane. Paqja ka qenë ndër synimet më sublimë të popullit të Kosovës gjatë historisë. E kaluara e tij është pa dyshim histori e lëvizjeve politike, e gjuhës, e kulturës dhe identitetit të njëjtë me të gjithë shqiptarët në rajon. Për më shumë, e kaluara e tij është histori e aspiratës për liri dhe e vullnetit për paqe. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të 2008- s, Kosova u dëshmuar si faktor paqes dhe stabiliteti në Europë dhe më gjerë.

Viti 2013 është një vit i rëndësishëm në arritjen e një paqeje përfundimtare pas Marrëveshjes së 19 prillit për normalizimin e relacioneve mes Kosovës dhe Serbisë si dy shtet të pavarura, e cila ka për qëllim të përmbyllë kapitullin njëshekullor të konfliktit dhe të luftës mes dy popujve. Pa dyshim që është hapur një kapitull i ri dhe re e relacioneve në mes të dy popujve të rajonit, por kjo kapitullin e re mund të shkruhet përfundimisht kur të jetë shprehur plotësisht kjo marrëveshje.

Marrëveshja do të jetë historike atëherë kur ta ndryshojë trënjësisht situatën në Veri të vendit dhe kur vërtet relacionet historikisht të ngarkuara mes Kosovës dhe Serbisë të fillojnë të shndërrohen në relacione të fqinjësisë së mirë. S'ka dyshim se dialogu dhe marrëveshja e arritur në Bruksel kanë qenë një ngritje e shtetit të Kosovës në skenën politike europiane. Kosova është bërë model për zgjidhjen politike edhe të dy sfidave të tjera historike në rajon; adresimi i relacioneve mes entiteteve në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe çështja e kontekstit të emrit të Maqedonisë mes Shkupit dhe Athinës.

## VETËDIJA HISTORIKE DHE VULLNETI POLITIK

Të gjitha këto aspekte të dhëna këtu japin një pjesë të përvojës sonë historike. Ato e reflektojnë vetëdijen tonë historike si pjesë e pandashme e qytetërimit europian perëndimor. Vetëdija historike e një populli ka një rol vendimtar në përcaktimin e pozitës së një shoqërie brenda dimensionit kohor dhe hapësinor. Ka disa parametra, të cilët gjatë historisë kanë shërbyer si paracaktues të fuqisë së një vendi dhe nga të cilat elitat politikë kanë parapërcaktuar orientimet për rolin

e një shteti apo të një shoqërie në një situatë të caktuar gjeopolitike. Kështu, faktorë si madhësia gjeografike apo demografike, kapaciteti ushtarak apo teknologjik, ekonomia apo resurset e tjera të një vendi kanë parapërcaktuar rrjedhin e historisë dhe fuqinë reale të një vendi.

Historikisht, faktorë të tillë kanë qenë vendimtarë dhe mbeten edhe më tutje në kuptimin e balancave të fuqive globale apo rajonale, që shpeshherë njihen si ekuilibri i forcës. Mirëpo, përveç këtyre faktorëve, ndër ta i cili shërben për të projektuar fuqi dhe për të krijuar një relacion dinamik mes kapaciteteve demografike, ushtarake dhe ekonomike të një vendi, është parametri i vullnetit politik. Vullneti politik është shumë shpesh edhe shfaqje e vetëdijes historike, e cila paracaktonte vetëbesimin e një populli. Vetëbesimi është i ndërlidhur me atë se sa një popull dhe elitat e tij janë të përgatitur psikologjikisht për procese kyçe strategjike.

Kështu jo rrallë vetëbesimin dhe forcën e gjen një popull në të kaluarën e tij. Përvoja historike për shtet të mirëfilltë dhe elita serioze shihet si një element me peshë në projektimin e vullnetit politik, në formësimin strategjik dhe për orientimin e partneritetit afatgjatë. Ajo shërben për planifikimin e së ardhmes pa humbur fokusin në situata të politikës ditore apo të veprimeve taktike. Si e tillë është bazë për kërkim të një pozicioni ndërkombëtar. Prandaj shteti i Kosovës nuk ka alternativë tjetër veç se të jetë pjesë e botës dhe institucioneve euroatlantike, meqë identiteti i Kosovës është identitet europian.

Asnjëherë gjatë historisë populli i Kosovës nuk i është dorëzuar ndonjë qytetërimi tjetër, por ka mbetur pjesë e pandashme e botës dhe e qytetërimit europian. Popujt që e kanë ndërtuar kulturën politike mbi një identitet të fuqishëm historik dhe psikologji të vetëbesimit, kanë ballafaquar me sukses kriza të brendshme, goditje nga jashtë dhe është kthyer përsëri në skenën e historisë. Shteti i Kosovës, si pjesë e peizazhit të shteteve të tjera në Europën Juglindore, është ndër të tjerash edhe produkt i vetëbesimit, vullnetit politik dhe vetëdijes sonë historike europiane.

*(Autori është ministër i Punëve të Jashtme në Qeverinë e Kosovës)*